



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a), dhe nenit 34.1 shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2017, mori këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Nexhat (Shaban) Rexhepi dhe Liman (Beqir) Jashari.
- II. Prona e paluajtshme e komunës që do të këmbehet ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr.7196-2, Zona Kadastrale Prishtinë, kulturë arë e klasës së III-të, Certifikata e pronësisë P-71914059-07196-2, e evidentuar si "Pasuri Shoqërore" Kuvendi Komunal Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr.7196-1, Zona Kadastrale Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-01796-1, në pronësi të pronarëve Nexhat (Shaban) Rexhepi dhe Liman (Beqir) Jashari.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e planit rregullues urban, kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të komunës, dhe se kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmbehen.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi duhet të evidentohen në librat kadastral të komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 462/01-0074239/17 më, 03.04.2017



KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dpl.